

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 18000000-9; 18110000-3; 18113000-4; 18141000-9; 33735100-2; 35113400-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,189,725.42 (tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë pikë dyzet e dy) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;
 - b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të marreveshjes kuader.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, Ligjin Nr.25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike" i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.26, datë 08.09.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i këtij kriteri dhe i vlerës përkatëse është bërë në përputhje me kufijtë e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore shërben për të vërtetuar besueshmërinë dhe kapacitetin financiar të operatorit ekonomik, nëpërmjet nivelit të xhiros së realizuar në një nga vitet e fundit financiare.

Ky kriter është i nevojshëm dhe proporcional, pasi i mundëson Autoritetit Kontraktor të vlerësojë aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje kuadër e kësaj natyre dhe përmase. Njëkohësisht, ai nxit operatorët ekonomikë që, përpara paraqitjes së ofertës, të vlerësojnë në mënyrë realiste kapacitetet e tyre financiare dhe mundësinë për realizimin me sukses të kontratës.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marreveshjes kuader.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe/se fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të deklaruara në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që mallrat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një tregues tepër i rëndësishëm , ndaj operatorët ekonomikë duhet

të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalent), e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e pajijeve të sigurisë dhe veshjeve mbrojtëse pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosija e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/autorizim nga distributori zyrtar për mallrat në tabelën e specifikimeve teknike bashkëlidhur DT, ku të specifikohet që operatori ekonomik është i autorizuar të ofrojë mallrat e kërkuara. Autorizimi i prodhuesit duhet të përmbajë gjithashtu të dhënat e kontaktit të përfaqësuesit të prodhuesit/distributorit (emri, emaili, telefoni). Në rast se, do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Argumentimi: Vendosija e këtij kriteri, është bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Objekt i këtij prokurimi është furnizimi i veshjeve, të cilat do të përdoren nga stafi i AGS sha. Dorezimi i Autorizimit të Prodhuesit, provon se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi i mallrave ose distributori zyrtar për të tregtuar mallrat objekt prokurimi në territorin e Shqipërisë, në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe kushtet e prodhuesit të tyre.

Nëpërmjet dorëzimit të këtij dokumenti nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktor sigurohet dhe garanton origjinalitetin, origjinën, cilësinë dhe përputhshmërinë me standardet teknike të mallrave.

Plotësimi i këtij kriteri duhet të dëshmohet nëpërmjet dokumenteve origjinale ose kopjeve të noterizuara të marrëveshjeve të partneritetit me kompaninë prodhuese të veshjeve. Ky kriter vendoset si kusht për sigurimin e AK në përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së punës gjatë ofrimit të furnizimit. Kriteri mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit, është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti ynë kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt

i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij që të kërkoj që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë origjinalitetin e produkteve të furnizuara, kjo nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit të lëshuar direkt nga prodhuesi i tyre ose distributori i tij. Për më tepër që këto dokumente janë të arritshme për operatorët ekonomikë që ushtrojnë aktivitet në këtë fushë dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skeda teknike/katalogun e prodhuesit ose fragmente të katalogut për mallin që prokurohet, ku të pasqyrohet dhe të specifikohet qartë malli me specifikimet teknike që ofrohen me specifikimet teknike e kërkuara në DT. Fragmentet e katalogut duhet të tregojnë qartë që janë pjesë e katalogut. Të dhënat teknike, të paktën ato të kërkuara në specifikimet teknike duhet të jenë në gjuhën shqipe. (te përkthyer dhe noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në pikën 6 të nenit 40 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara specifikimet teknike, AK ka të drejtë të kërkojë edhe paraqitjen e katalogeve ose fragmenteve të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të jenë të kuptueshme nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Kjo kërkesë në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. AGS sha duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij që të kërkoj që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë origjinalitetin e produkteve të furnizuara dhe të sigurojë veshje realisht të standardizuara dhe të sigurta.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së ofertave mostrat (kampionet), të paktën 1 (një) copë në paketim origjinal për produktet e listuara me poshte:

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat do të paraqiten për produktet e mëposhtme:

- Kominoshe verore, zëri 9 (pa qendrisje të inicialeve shembuj nese nuk realizohen në kohe);
- Bluzë Antistatike, zëri 16
- Xhaketë rezistente ndaj zjarrit Antistatike , zëri 13;
- Pantallona verore rezistente ndaj zjarrit antistatike, zëri 14;
- Syzet e sigurisë të polarizuara PS18, zëri 6
- Këpucë sigurie S3 SRC ESD 94405-00, zëri 21;
- Këpucë sigurie S3 ËR SRC, zëri 22;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40/6 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: **mostra**

të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat...

Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, kërkesa për paraqitjen e mostrave i jep mundësinë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) të vlerësojë drejtpërdrejt funksionalitetin, cilësinë dhe përshtatshmërinë e produkteve që do të përdoren, si dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit dhe me parametrat e paraqitur në skemat teknike ose katalogët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik.’

Këto veshje dhe pajisje janë specifike dhe përdoren në ambiente me rrezikshmëri të lartë, ndaj verifikimi i përputhshmërisë së tyre nëpërmjet krahasimit me mostrat është i domosdoshëm, për të shmangur furnizimin me produkte jo origjinale dhe për të garantuar sigurinë e punonjësve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40/8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektesisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoritet e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës dhe specifikimeve teknike

Këto specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. të ndryshuar si dhe në përputhje me nevojën konkrete të Autoritetit Kontraktor për sigurimin e veshjeve të punës, pajisjeve të

sigurisë dhe materialeve mbrojtëse për punonjësit që kryejnë punime elektrike dhe punime të tjera speciale me risk të lartë.

Duke qenë se këto procese pune përfshijnë ekspozim ndaj rreziqeve elektrike, mekanike dhe mjedisore, përcaktimi i saktë i kërkesave teknike është thelbësor për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Gjithashtu në hartimin e specifikimeve teknike të mallrave të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur jemi bazuar edhe në standarde kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mbrojtjeje për punonjësit. Ato përfshijnë kërkesa të detajuara mbi cilësinë e materialeve, rezistencën ndaj faktorëve të jashtëm (si tensioni elektrik, temperaturat e larta, konsumimi mekanik), komoditetin gjatë përdorimit dhe jetëgjatësinë e produkteve. Më konkretisht, në hartimin e specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë kërkesat e detajuara në mënyrë specifike në tabelën bashkëlidhur. Per shembull:

Për veshjet e punës nga zëri 9-20,24 janë vendosur standarde ndërkombëtare, kërkesa për materiale rezistente ndaj konsumit, izolim të përshtatshëm dhe dukshmëri të lartë (high visibility), në përputhje me natyrën e punimeve në terren dhe kushtet atmosferike, si rezistente ndaj flakës, parandalimin dhe depërtimin e ujit, antistatike.

Për pajisjet e sigurisë përfshirë helmata mbrojtëse, dorezat, syze , këpucë sigurie, cizmet janë vendosur standarde, kërkesa të cilat duhet të përmbushin standardet përkatëse të sigurisë, si të jenë lëkure, rezistente ndaj karburanteve , izolim ndaj te ftohtit etj.

Për pajisjet e tjera speciale janë vendosur kërkesa që të jenë të certifikuar sipas standardeve përkatëse.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të mos kufizojnë konkurrencën, duke shmangur referencat ndaj markave, origjinës apo prodhuesve të caktuar, por duke përcaktuar vetëm karakteristika funksionale dhe performancë të kërkuar. Çdo referencë e mundshme është shoqëruar me termin “ose ekuivalente”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.